



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BASHKIA ROSKOVEC**

Adresa: Lagja nr.1 Roskovec.web:www.bashkiaroskovec.gov.al.nr.tel:0387 80242

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE  
PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL  
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE  
(Specialist)**

**Lloji i diplomës “Drejtesi , Ekonomi, Finance”  
Niveli minimal i diplomës “Diplome e Nivelit te Pare”**

Në zbatim të Nenit 22 dhe të Nenit 25, të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, VKM-së Nr.142 datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicionëve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar ; si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave (I ndryshuar), **Bashkia Roskovec** shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

- ❖ 1 (nje) Specialist në Sektorin e Tatim-Taksave , ne Njesine Administrative Strum Bashkia Roskovec

Shpallja eshte e hapur per te gjithë nepunesit civil te se njejtës kategori ne te gjitha institucionet pjese e shërbimit civil. Nese nuk ka nje fitues nga procedura e levizjes paralele, plotesimi i vendit vakant do te realizohet me procedurën e Pranimit në shërbimin Civil.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe Praniminë Shërbimin Civil në kategorin ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë.

- Afati për dorëzimin e dokumentave për

**LEVIZJE PARALELE: 04.10.2019**

- Afati për dorëzimin e dokumentave për

## PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: 09.10.2019

### Përshkrim i Përgjithshëm

*Specialisti I tatim-taksave përgjigjet tek Pergjegjesi I Sektorit ,për menaxhimin e çështjeve që lidhen me regjistrimin e mases se detyrimeve te paguara nga subjektet private dhe institucionet shtetërore, plotesimin e evidences mujore dhe evidencen e pergjithshme mbi realizimin e te ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, ushtrimin e kontrollit ne terren per evidentimin e aktivitetit qe ushtron subjekti, siperfaqes se nderteses ku ushtrohet aktiviteti, evidentimin e subjekteve te reja si dhe atyre qe mbyllin aktivitetin.*

### DETYRAT

Detyrat e këtij sektori:

- Të planifikojë, krijojë, organizojë dhe menaxhojë sistemet e regjistrimit të subjekteve të taksueshme, llogaritjes së detyrimit fiskal të taksapaguesve publikë dhe privatë brenda juridiksionit të Bashkisë;
- Të ndjekë dhe evidentojë në mënyrë të vazhdueshme subjektet e regjistruara pranë organeve tatimore;
- Të studiojë mundësinë e një kontrolli sa më efikas të rrjetit të tregtisë në bashkëpunim me struktura të tjera të bashkisë, përgjegjëse për planifikimin e kontrollit urban dhe infrastrukturëpublike;
- Të përgjigjet për evidentimin dhe licencimin e të gjitha subjekteve tregtare që ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin e Roskovecit;
- Ndjek detyrat funksionale dhe informon në mënyrë periodike eprorin direkt për problemet e ndryshme në lidhje me zbatimin e legjislacionit në fuqi;
- Përcakton dhe miraton dokumentacionin teknik e ekonomik të domosdoshëm për kryerjen e

shërbimeve të ndryshme ndaj subjekteve që licencohen nga Bashkia;

- Përgatit materiale mbi realizimin e të ardhurave dhe tarifave vendore për t'u paraqitur në Këshillin Bashkiak dhe ndjek zbatimin e vendimeve të marra;
- Ndërgjegjëson publikun me shërbimet e ofruara nga sektori nëpërmjet përgatitjes së materialeve promociionale;

## I. Levizja Paralele

Kjo procedurë është e hapur vetëm për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

**Kushtet minimale** që duhet të plotësojnë kandidatët për lëvizjen paralele janë:

1. Të jetë nëpunëscivil i konfirmuar brenda të njëjtës kategori.
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
3. Të ketë të paktën vlerësim e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”.

Kriteret e vecanta për këto pozicion janë:

- a) të zoterojë diplome minimumi 3-vjecare , Diplomë “Bachelor”, në Degën “Ekonomik Biznes. Nëse diploma është marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi
- b) të ketë të paktën 1 vit punë.
- c) Të ketë njohuri të një gjuhe të huaj;

Kandidati duhet të dërgojë **me postë ose dorazi në një zarf** të mbyllur, në zyrën e Drejtorisë Juridike dhe të Burimeve Njërëzore, të Bashkisë Roskovecs, këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit.
- Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.

- Fotokopje e diplomës me listën e notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- Fotokopje e vlerësimit të fundit vjetor.
- Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Vërtetim gjëndjes gjyqësore dhe shëndetsore.

Dokumentet e mësipërme duhet të dorëzohen deri më datë **04.10.2019**

Rezultatet nga verifikimi paraprak të kushteve minimale të procedurës së levizjes paralele dhe të përmbushjes së kriterëve specifikë të vendit të punës do të dalin në datën **07.10.2019** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin

- Sherbimi Kombëtar i Punësimit,
- Faqen zyrtare të Internetit të Bashkisë,
- Stendën e informimit të publikut,

Kandidatët që nuk kualifikohen do të njoftohen individualisht nga njësia e Burimeve Njëzore, Informacionit dhe Marrdhënieve me Publikun për shkaqet e moskualifikimit në të njëjtën ditë me shpalljen e listës së verifikimit paraprak të kandidatëve.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Drejtorinë Burimeve Njëzore, brenda 3 ditëve kalendrike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendrike nga data e përfundimit të afatit të ankimeve.

Pas përfundimit të procedurës së sipërpermendur nepunësi me i lartë civil i institucionit brenda dy ditëve kalendrike urdheron ngritjen e komisionit të brendshëm.

Komisioni i brendshëm brenda 2 (dy) ditëve kalendrike nga data e krijimit të tij, zhvillon intervistën me gojë.

Intervista me gojë do të zhvillohet në ambientet e Bashkisë Roskovec më datë **17.10.2019 ora 11:00.**

**Në intervistë kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në këto fusha:**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

- Ligji nr.8652 dt.31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore” i ndryshuar.
- Ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe aktet nenligjore e dala per zbatim te tij.
- Kodi i Punes i Republikes së Shqiperise;
- Kodin e Procedurave Administrative
- Kodi Civil
- Kodi i Proçedurës Civile
- Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
- Njohjen e kërkesave te Rregullores së Brendshme, e Kodin e Etikes të miratuar nga Këshilli Bashkiak Roskovec.
- Ligji nr.9632 date 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore”

### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:**

Kandidatet do të vlerësohen nga **Komisioni i Brendshem për Lëvizjen Paralele i ngritur në Bashkin Roskovec**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a. **40 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, 10 pikë për çertifikimin pozitiv.
- b. **60 pikë** për intervistën me gojë;

Komisioni, në përfundim të vlerësimit, rendit kandidatet sipas pikeve te grumbulluara dhe I dergon listen njesise se burimeve njerezore te institucionit. Njesia e burimeve njerezore e institucionit, brenda 24 oreve nga dita qe komisioni i njofton vendimin e tij, njofton individualisht kandidatet qe kane konkuruar per rezultatin e tyre. Kandidatet, pavarsisht nga e drejta per tu ankuar kane te drejte te bejne ankim me shkrim dhe ne komisionin e brendshem per levizjen paralele per rezultatin e vleresimit, brenda 3 (tre) diteve kalendarike nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankuesesi merr pergjigje brenda 3 (tre) diteve kalendarike nga data e perfundimit te afatit.

Komisioni më **date 23.10.2019** njofton për vendimin e përzgjedhjes, Njesine Pergjegjese te Menaxhimit te Burimeve Njerezore.

Njesia Pergjegjese e Menaxhimit te Burimeve Njerezore, me date **28.10.2019** shpall fituesin.

**Njoftimi do të bëhet:** në portalin

- “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”
- “Faqen zyrtare të Bashkise
- “Stenden e Bashkisë Roskovec.

## **II – Pranimi ne Sherbim Civil**

Nëse në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele nuk ka fitues, plotësimi i vendit vakant do të realizohet nëpërmjet procedurës së pranimi në shërbimin civil në kategorinë e kzekutive.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar:

### **Kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta**

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotrojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar( hequr) sipas këtij ligji.

### **Kriteret e veçanta për këtë pozicion janë:**

- a) Te zoteroje dibrleme 3- vjecare , Diplomë “Bachelor”, në Degën Ekonomi-Finance, Biznes, Kontabilitet, Finance Banke, edhe diploma

e nivelit “Bachelor” duhet te jete ne te njeten fushë. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

b) te kete deri në 1 vit punë.

c) Te kete njohuri te një gjuhe te huaj;

### **Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit**

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Drejtoris së Burimeve Njërëzore, Informacionit dhe Marrdhënieve me Publikun të Bashkisë Patos, këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit.
- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- Fotokopje e diplomës me listën e notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Vërtetim gjëndjes gjyqësore dhe shëndetsore.

### **Afati i fundit i pranimit te kandidateve do te jete data 09.10.2019**

Rezultatet nga verifikimi paraprak te kushteve minimale te procedures e pranimit në shërbimin civil dhe te permbushjes se kriterëve specifike te vendit te punes do te dalin ne daten **19.10.2019** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojne konkurimin, ne portalin ”Sherbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e Internetit të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut.

Gjithashtu, po në këtë datë kandidatët që nuk janë kualifikuar do të njoftohen nga Njesia Pergjegjese e Menaxhimit te Burimeve Njerezore, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatet paraqiten ne Njesine Pergjegjese te Menaxhimit te Burimeve Njerezore brenda 5 diteve kalendarike nga dhe ankuesi merr

pergjigje brenda 5 diteve kalendarike nga data e perfundimit e afatit te ankimit.

Konkurimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me goje, do te zhvillohet ne ambientet e Bashkise Roskovec më datë **05.11.2019 ora 10:00.**

**Në konkurimin me shkrim dhe intervistë e strukturuar me goje, kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në këto fusha:**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr.8652 dt.31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore” i ndryshuar.
- Ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe aktet nenligjore e dala per zbatim te tij.
- Kodi i Punes i Republikes së Shqiperise;
- Kodin e Procedurave Administrative
- Kodi Civil
- Kodi i Proçedurës Civile
- Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
- Njohjen e kërkesave te Rregullores së Brendëshme, e Kodin e Etikes të miratuar nga Këshilli Bashkiak Roskovec.

### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

Kandidatët do të vlerësohen nga Komisioni i Përhershëm i Pranimit, i ngritur pranë Bashkise Roskovec.

Totali i pikeve te vleresimit te kandidateve eshte 100 pike te cilat ndahen perkatesisht:

- a. 15 pike për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. 25 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. 60 pikë për vlerësimin me shkrim.

Komiteti i Përhershëm i Pranimit, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin “Specialist I Tatim-taksave”.

Në rast se dalin fitues më shumë se një kandidat, me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 13, të kreut IV, të Vendimit të Këshillit të



Minstrave nr.243, datë, 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorin ekzekutive”.

Komiteti i Përhershëm i Pranimibrënda 24 (njëzet e katër) orëve, pra në **date 06.11.2019** njofton listen e fituesve, Drejtorine Burimeve Njërëzore, Informacionit dhe Marrdhënieve me Publikun.

Njesia e Menaxhimit të Burimeve Njërëzore, me **date 19.11. 2019**, shpall listen e fituesve, Njesise se menaxhimit të Burimeve Njerezore.

**Njoftimi do të bëhet:**

-“Shërbimi Kombëtar i Punësimit”

-“Faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec “

-“Stenden e informimit public”

Per sqarime te metejshme mund te kontaktoni ne:

e-mail: [oltaristani@yahoo.com](mailto:oltaristani@yahoo.com)

nr.tel: 0387 80242

**NJESIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJEREZORE**

**BASHKIA ROSKOVEC**